

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Shega Urban Line & Tours”

Shega-Trans SHA, me NIPT K51504004P, me aksionar të vetëm dhe administrator Z. Ervin Shijaku, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19.07.1973 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me Pasaporte nr.personal H30719043R, ka vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe nënshkruan Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga përcaktimet në këtë akt themelimi dhe në fuqi dhe nga statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më datë 28.02.2020, unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Shega Urban Line & Tours SHPK”.

Themeluesi i shoqërisë është shoqëria Shega-Trans SHA me NIPT K51504004P, me aksionar të vetëm Z. **Ervin Shijaku**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19.07.1973 dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar me pasaportën me Nr. personal H30719043R.

Neni 2 – Emërtimi dhe Selia

Emërtimi i shoqërisë është “Shega Urban Line & Tours”.

Selia e shoqërisë ndodhet në “Njësia Bashkiake Nr.6, Sheshin Garibaldi, brenda ambienteve të ish kombinatit tekstil, godinë 2-katëshe, kati i parë.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaku i Shoqërisë mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa herë sipas një vendimi të posaçëm.



Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është:

1. Transport kombetar dhe nderkombetar i pasagjerëve për të tretë dhe për nevoja të vetë shoqërisë; Transport të udhetarëve në linja urbane dhe interurbane; Transport Turistik.
2. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.

Neni 5 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është *100 000 (njëqind mijë) lekë.*

Ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë Tregtare “Shega Urban Line & Tours” SHPK është Shega-Trans SHA, zotëruesi i *1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 (njëqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

Neni 6 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të statutit dhe ligjit në fuqi.


Neni 7 – Organet drejtuese

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i cili do të zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Kostandin Foni, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.07.1985, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.personal I50718068A, për një periudhe 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërsëritje.



Shoqëria përfaqësohet pranë çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat, si dhe në marrëdhënie me të tretet nga administrator i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 8 – Organizimi

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit dhe statutit.

Neni 9 – Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga organet e statutit të nënshkruara nga ortaku themelues sipas ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Shega Urban Line & Tours”

**Shega Trans SHA
Aksionari i vetëm
Z.Ervin Shijaku**

